

Procesverbal

Konsultim publik : *Bashkia Pogradec*

Data : 20/10/2022

Ora : 11:00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 46 persona të pranishëm (12 gra dhe 34 burra).

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Paketa Fiskale dhe Buxheti 2023

Pjesëmarrës : **Johan Sterio (Nënkryetar I Bashkisë)**

Paskalino Ziko (Nënkryetar I Bashkisë)

Irsa Karapanca (Drejtoreshë Financës)

Enjela Karafili (Drejtoreshë, Drejtorja e Tatimeve dhe Taksave)

Shpresa Blaceri (Këshilltar, Bashkia Pogradec)

Drita Seitllari (Këshilltar, Bashkia Pogradec)

Jona Bojko (Sekretare Këshilli)

Matilda Tollaku (Sekretaria e Këshillit)

- Takimi drejtohet nga Nënkryetarët e Bashkisë Johan Sterio dhe Paskalino Ziko të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :
- Sistemin e Ndrimit që po adaptohet në Bashkinë Pogradec
- Lagjia Gani Omcani është duke u përfunduar
- Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës ka vazhduar me shtrimin e rrugicave të vogla nëpër lagje.
- Te Zona e Ish Parkut, zona industriale kemi miratuar projektin dhe investimi do të fillojë vitin që vjen.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën shprehën problematikat që ata kanë .

Banori 1:Falenderojmë Bashkinë për investimet që ka bërë në qytetin e Pogradecit, sot do të ngre disa problematika:

Kur ka rreshje shiu ka përmytje në disa lagje të cilat prishin infrastrukturën.

Pemët e vjetra duhet të prihen sepse në momentin që ka erëra të forta bijen dhe mund të shkaktojnë dëme të njerëz dhe objekte. Cilësia e Investimeve të bëra lë për të dëshiruar.

Shumë tregëtarë kanë zënë hapësirat publike.

Paskalino Ziko: Shumë shpejt fillon investimi për një treg modern të ish-NPV I cili do të jetë një treg me standarte bashkëkohore. Përsa i përket përmytjeve kur ka rreshje është eliminuar si fenomen në pjesën më të madhe.

Ladi; Në lagjen dy (2) u bënë investime dhe nuk u hoqën bordurat, u premtua të bëhej një lulishte por nuk u bë. Tarifat e ujit të pijshëm janë ngritur për vitin 2022 .

Johan Sterio: Ndryshimi i cmimit të ujit është bërë që në vitin 2020.Përsa i përket ujësjellsit në Cërravë në kontratë është parashikuar që të përfundojë deri në fund të vitit.

Tarifa ka qënë 300 lekë, sot është 200 lekë; 0-4 m³=22lekë: 4-14 m³= 62lekë

Ujrat e përdorur: 15lekë 0-4 m³: 35lekë +4m

Banori I lagjes Divizioni: Kanë erdhur disa herë për të rregulluar kanalizimet dhe rrugër dhe asgjë nuk është bërë.Në lagje është vendosur vetëm një dritë që më shumë është e fikur.Kemi dhe problem me legalizimin e pallatit.

Banori 4: Unë kam disa pyetje: A ka pasur ndonjë projekt Bashkia për liqenin ose turizmin? Sa është buxheti i taksave që vilet nga qytetarët?

Falenderojmë kryetarin që ka mundur disa ambiente për pensionistët.

Enjela Karafili: Të ardhurat mujore janë 30 milion , ndërsa vjetore shkojnë 340 milion në vit. Doja të theksoja që familjet që kanë nevojë për ndihmë, pensionistët e vetmuar, gratë kryefamiljare ju është hequr taksa. Familjeve me ndihmë ekonomike dhe pensionistëve ju është reduktuar.

Banori Lagjes Gani Omcani: Firma që ka bërë punimet e lagjes Gano Omcani e ka lënë rrugën gropa gropa që tani.

P. Gjylameti: Lagjia 4 a do të keta investime? Rugicat tek shkolla e parë shqipe janë në gjendje të keqe.

Banor I lagjes 1: Biznesi është në gjendje të veshtirë taksat janë shumë të larta. Taksa e pastrimit është rritur me 60%, taksa e gjelbërimit me 50%

Kryetari I org së dëshmorëve: Të bëhet një ndërhyrje tek varrezat e dëshmorëve, për makinat që parkohen para derës së hyrjes.

Vasil, lagjia sot7:Rruga e Unazës ka vetëm 3 vjet që ka përfunduar dhe është dëmtuar që tani. Varrezat nuk kanë ndricim, nuk ka rrugë dhe ujë. Cmimi I druve të zjarrit është rritur frikshëm.

Paskalino Ziko: Bashkia ka dy varreza qyteti. Varrezat e Zagorcanit do të zgjerohen. Bashkia ka hartuar projektin por do të bëhet shpronësimi.Uji ka qënë I vendosur në varrezat e Zagorcanit por është prerë për arsye keqpërdorimi.

Banor I lagje Kala:Falenderoj bashkinë që rregulloi shkallqt e lagjes Kala,por a do të ketë ndërhyrje për ndnj rrugë ose suvatim?

Banor I lagjes 2: Tek lagjia 2 nga projekti për suvatimin e pallateve ngelën dy pa suvatuar, ishte planifikuar të bëhej një lulishte dhe nuk u bë.Ka makina të parkuara për vite me rradhe duhet të ndërhyja Policia Bashkiake.Është problem gjithashtu qentë që I sjellin nga qytetet e tjera si korca.

Eduart Shebeku: Sa kanë qënë të ardhurat në Bashki nga turizmi dhe sa janë shpenzuar?A ka projekt për të rijntë për sportin, kënde , palestra?

Mbajtësi i procesverbalit

Jona Bojko